

Portet e rajonit në projekte të përbashkëta evropiane

15 Nëntor 2011



Porti i Durrësit dhe ai i Barit për nga distanca dhe volumi i përbashkët i punës që kryejnë janë si dy anë të së njejtës medalje- u shprehën sot paradite gjatë Seminarit për projektin “Watermode” përfaqësuesit e portit të vendit fqinj.

Në takimin e organizuar në një nga mjediset e Autoritetit Portual të Durrësit, drejtori i këtij Autoriteti, Eduard Ndreu tha se këndvështrimi i administrimit të portit vitet e fundit është lidhur ngushtë me përmirsimin e nivelit të menaxhimit si dhe me uljen e kostove të shërbimeve.

Kjo është mënyra më e mirë për të rritur numrin e transportuesve përmes portit të Durrësit, i cili tashmë po kthehet në një port rajonal që u shërben Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë dhe në një të ardhme edhe Serbisë së Jugut.



Sipas drejtorit të përgjithshëm Ndreu, Autoriteti portual po investon aktualisht vetëm në infrastrukturë, si në rritjen e kapacitetit të kalatave dhe së shpejti edhe në thellimin e pjesës nënujore të basenit. Procesi intensiv i privatizimit të shërbimeve ua ka kaluar investimet në superstrukturë vetë firmave dhe kompanive private.

Rruga e Kombit dhe rruga e Arbit, punimet e së cilës do të nisin shumë shpejt e favorizojnë edhe më tej portin detar, që është vendtakimi mes rrugëve ujore dhe atyre tokësore në përgjithësi-shtoi drejtori Eduard Ndreu.

Përfaqësuesja e portit të Barit Michela Cariglia, nënvizoi rëndësinë e përfitimit të investimeve nga programet e Bashkimit Evropian. Autoritetet portuale janë institucione që mund të përfitojnë nga partneriteti i përbashkët në kuadër të integritimit në Bashkimin Evropian-shtoi përfaqësuesja italiane.

“Ne shohim vazhdimisht ndryshime pozitive në portin detar të Durrësit, me të cilin kryejmë rreth 90 përqind të lëvizjes së udhëtarëve me Shqipërinë në shkallë vendi-tha Cariglia.

Porti i Durrësit është anëtar i Projektit 3-vjeçar Watermode që nga Janari 2009. Zona e përshirë në këtë program është një zonë me trafik të konsiderueshem, me hyrje dhe dalje të shumta. Ky trafik suportohet kryesisht nga infrastruktura rrugore e cila nuk ka

qenë e planifikuar për të përballuar një fluks të tillë. Kjo shkakton një impakt negativ në konkurrencën me bazë territoriale dhe mjedisin, për shkak të ndotjes së ajrit, zhurmës dhe mobilitetit të reduktuar.

Objektivi i projektit është të promovojë koordinimin mes aktoreve që merren me logjistikën për një menaxhim më të mirë të politikave të transportit dhe një implementim eficient të platformave multimodale, përcaktimi i standardeve të cilësisë në shërbimet e transportit dhe ato logjistike, implementi i studimeve pilote për multimodalitetin, bazuar në rrugët detare si më të qëndrueshme nga pikpamja mjedisore. Projekti synon të fuqizojë transportin ujor duke e pozicionuar fuqishëm atë në zinxhirin logjistik.

#

Draft Axhenda e “Seminarit të përbashkët Transaksional”

Takimi fillon në orën 9:00 me rregjistrimin e të pranishmëve.

Vëndi: Qendra e Trainimeve, Porti i Durrësit

- 09:00-09:30 Falenderimi dhe fillimi i takimit nga kordinatori i Projektit për Autoritetit Portual Durres.
- 09:40 -10:00 “Prezantim i Portit të Durrësit” nga Drejtori Ekzekutiv Z. Eduard NDREU
- 10:00- 10:20 “Helsinki la Valletta, Korridori Multimodal” Prezantim nga Presidenti i Portit të Barit. Mr. Francesco P. Mariani.
- 10.20-10.40 Diskutim mbi “Marrëdhëniet Institucionale”, Ndërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe Autoritetit Portual të Barit. Fjalën do ta mbajë Sekretari Gjeneral i Portit të Barit Mr. Mario Sommariva.
- 10.40-11.00 Prezantim i projektit Watermod. Relator do te jete Mr. Mara Pittacolo, Autoriteti Portual i Venecias.
- 11.30-11.50 Diskutim “Zhvillimi i biznesit dhe investimeve në Shqipëri” Drejtori i Alb-Konfindustria Z.Gjergj Buxhuku.

11.30-11.50 Diskutim “Zhvillimi i Infrastrukturës Rrugore në shqipëri” Drejtoresha e Institutit të Transportit. Ms. Brikena TARE.



